



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

KËSHILLI I PËRMBARIMIT

Nr. 1276/3 Prot

Tiranë, më 21.10 2025

VENDIM

Nr 72 datë 21 / 10 / 2025

PËR MIRATIMIN E “FORMULARI I VETVLERËSIMIT PËR PËRMBARUESIT GJYQËSOR SHTETËROR” DHE “FORMULARI I VETVLERËSIMIT PËR KRYETARËT E ZYRAVE PËRMBARIMORE”.

Këshilli i Përmbarimit në zbatim të detyrimeve të përcaktuar në nenet 46- 62 të Ligjit nr.8/2023 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, Urdhërit nr.167 datë 25.03.2024 të Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizmin dhe funksionimin e Këshillit të Përmbarimit” i cili në nenin 3 të tij “Kompetencat funksionale të Këshillit të Përmbarimit” ka të përcaktuar në pikat b); c) dhe ç) të tij se ky këshill miraton programin që përcakton listën e përmbaruesve dhe kryetarëve të zyrave përmbarimore për të cilët kryhet vlerësimi përgjatë vitit pasardhës dhe periudhën e vlerësimit, përcakton formën e formularit standard për vlerësimin etik dhe profesional të përmbaruesit gjyqësor, merr vendimin për vlerësimin etik dhe profesional të përmbaruesit gjyqësor shtetëror, nenit 5 të po këtij urdhëri si dhe procesverbalit të mbajtur në datën 21.10.2025:

VENDOSI:


1. Miratimin e “Formulari i vetvlerësimit për përmbaruesit gjyqësor shtetëror”.
2. Miratimin e “Formulari i vetvlerësimit për kryetarët e zyrave përmbarimore”.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.

PËR KËSHILLIN E PËRMBARIMIT


KRYETAR

ISMAIL SHEHU



ANËTAR

ERGYS QIRICI



ANËTAR

FITIM KOÇIAJ

